



KOMUNA E NOVOBËRDËS

Komuna e Novobërdës, 23.02.2026

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare.

1. Komuna e Novobërdës fton të gjitha Organizatat Joqeveritare (OJQ) të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës së të cilave është i fokusuar në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, që të aplikojnë për mbështetje financiare për zbatimin e projekteve në fushën e rritjes së qasjes, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve bazë dhe përmirësimin e shërbimeve sociale për gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës dhe personat që jetojnë në përjashtim social.

2. Në përputhje me këtë thirrje publike, OJQ-të mund të aplikojnë me projekte/programe në fushat prioritare si më poshtë:

1. Zbatimi i mbrojtjes për gratë dhe fëmijët e tyre që janë të rrezikuar nga dhuna fizike, psikike dhe ekonomike në familje.
2. Realizimi i projekteve dhe programeve nga kjo fushë që janë në interes publik.

3. OJQ mund të paraqesë vetëm një projekt, i cili do të përfshijë dhe do të kontribuojë në promovimin e aktiviteteve të përcaktuara në pikën 2 të kësaj Thirrjeje Publike.

4. Vlera totale e planifikuar e kësaj thirrjeje është **160,000.00(njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro.**

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune nga dita e publikimit të thirrjes publike, përkatësisht nga 24.02.2026 deri më 13.03.2026.

6. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në Regjistrin e Organizatave Joqeveritare të Republikës së Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Novobërdës, dhe që veprojnë dhe janë të regjistruara të paktën një vit para publikimit të kësaj thirrjeje publike.

OJQ që aplikon duhet të dorëzojë dëshmi se gjatë vitit të fundit është marrë me aktivitete për mbrojtjen e qytetarëve që përjetojnë dhunë në familje, kopje të licencës, si dhe nëse ka qenë përfituese e fondeve nga Komuna e Novobërdës, duhet të dëshmojë se i ka arsyetuar ato përmes raporteve financiare.

Pas nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të dorëzojë dëshmi se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetim për vepra penale, si dhe dëshmi se OJQ ka zgjidhur të gjitha çështjet e hapura lidhur me pagesën e kontributeve dhe taksave që mund të kenë qenë të papaguara.

7. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularin e paraparë, i cili së bashku me Udhëzuesin për Aplikantët gjendet në faqen e internetit:

<https://kk.rks-gov.net/novoberde/sr/>

Dokumentacioni i plotë duhet të dorëzohet me postë ose personalisht në adresën:

Komuna e Novobërdës
Bostane p.n.
16000 Novobërdë

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimi i tyre, kontraktimi, burimet, koha dhe mënyra e paraqitjes së ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari i zbatimit të thirrjes janë të paraqitura në mënyrë të detajuar në Udhëzuesin për Aplikantët.

Për mbështetje financiare do të shqyrtohen vetëm projektet që janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar dhe që i përmbushin plotësisht kushtet e kësaj thirrjeje publike.

8. Të gjitha pyetjet lidhur me këtë thirrje publike mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën:

info.novoberde@rks-gov.net

Predsednik opštine

Saša Milošević



Te dorzohen:

Zyres se kryetarit,
Drejtoris per buxhet dhe financa,
Drejtoris se Administrates,
Arhivi.